



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1143/4 prot.

Tiranë më 13.10.2017

REKOMANDIM

Nr. 39, datë 13.102017

MBI

ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

Baza Ligjore: Ligji Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, nenet 30, 31 dhe 32 të tij.

Ligji Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

Në zbatim të Urdhrit Nr.208 datë 30.08.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "EUROGHICI-SECURITY shpk" Tiranë, me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit "EUROGHICI-SECURITY shpk" Tiranë.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrit Nr.208 datë 30.08.2017 të Komisionerit.

Kontrolluesi "EUROGHICI-SECURITY shpk", është subjekt juridik me NIPT: K31929010K, me objekt aktiviteti: Ruajtjen e vendit dhe vlerave materiale e monetare, ruajtja e jetës së personelit, ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve private dhe publike etj.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim u konstatua:

1. Kontrolluesi nuk ka plotësuar detyrimin për "Njoftim" pranë Zyrës së Komisionerit përpara fillimit të aktivitetit të tij, çka përbën shkelje administrative të nenit 21 të ligjit;
2. Kontrolluesi nuk disponon rregullore për mbledhjen përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale, çka përbën shkelje administrative të nenit 27 të ligjit;
3. Kontrolluesi ka nënshkruar "Deklaratë Konfidencialiteti" me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale por formati i tyre nuk është sipas

modelit standard të miratuar nga Komisioneri, çka përbën shkelje administrative të nenit 28 të ligjit;

4. Kontrolluesi mbikëqyr ambientet e brendshme dhe të jashtme nëpërmjet sistemit të video-survejitimit. Koha e ruajtjes së të dhënave në sistem konstatohet të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë. Në hyrje të ambienteve në të cilat kontrolluesi ushtron aktivitetin, janë vendosur tabela informuese sipas modelit standard të miratuar nga Komisioneri.
5. Kontrolluesi nuk ka publikuar *"Politikat e Privatësisë"* në portalin zyrtar të <http://www.eurogjici-security.com>, çka përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit. Informacioni i publikuar në *"Politikat e Privatësisë"*, duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë;
6. Kontrolluesi nuk informon subjektet e të dhënave *"punëmarrës"* në lidhje me përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemit gjeolokalizimit (GPS) të vendosur në mjetet motorrike të kompanisë dhe me të cilët lëvizin me qëllim ushtrimin e detyrave të ngarkuara. Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit;
7. Në kontratën nr. 351 Prot. datë 09.03.2017, me objekt: instalimi dhe konfigurimi i sistemit të alarmit dhe i sistemit të vëzhgimit me kamera me pajisjet e SHPSF, konstatohet se nuk është hartuar kontrata sipas aneksit nr. 1 të Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 mbi *"Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi."* Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 20 të ligjit;

Zyra e Komisionerit konkludon se kontrolluesi nuk ka respektuar detyrimet ligjore të parashikuara në nenet 18, 20, 21, 27 dhe 28 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar si dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 mbi *"Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi."*

Zyra e Komisionerit vlerëson faktin se kontrolluesi ushtron aktivitetin si Shoqëri që ofron *"Shërbime Private për Sigurinë Fizike"* dhe për funksionimin e këtij aktiviteti mbështetet në ligjin nr. 75/2015 *"Për shërbimin privat të sigurisë fizike"* si dhe aktet nënligjore si rregullore, udhëzime dhe vendime të dala nga Policia e Shtetit.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"*, me qëllim ushtrimin e së drejtës për tu dëgjuar nga Zyra e Komisionerit përpara marrjes së vendimit përfundimtar, kontrolluesi është njoftuar zyrtarisht dhe ka marrë pjesë në seancën dëgjimore që u zhvillua më datë 09.10.2017.

Përfaqësuesi i kontrolluesit u paraqit në seancë dëgjimore dhe deklaroi se më datë 15.09.2017 ka kryer *"Njoftimin"* pranë Zyrës së Komisionerit, në lidhje me përpunimin e të dhënave

personale dhe më datë 21.09.2017 ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit prova dhe fakte që dokumentojnë rekuperimin e menjëhershëm të shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar si vijon:

1. Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale;
2. Deklaratë konfidencialiteti sipas modelit standard të miratuar nga Zyra e Komisionerit;
3. Dokument që informon subjektet e të dhënave "punëmarrës" në lidhje me përdorimin e sistemit të gjelokalizimit GPS në mjetet motorrike të shoqërisë dhe me të cilët lëvizin me qëllim ushtrimin e detyrave të ngarkuara;
4. Aneks kontratë tip për përpunimin e të dhënave personale nga palë të treta.

Mbas verifikimit të dokumentacionit të grumbulluar gjatë procesit të hetimit dhe provave të paraqitura nga kontrolluesi më datë 21.09.2017, Zyra e Komisionerit konkludon se:

1. Kontrolluesi nuk e ka plotësuar detyrimin për informimin e subjekteve të të dhënave, sipas pikës së pestë të procesverbalit të mbajtur. Publikimi i "Politikave të Privatësisë" në portalin <http://www.eurogjici-security.com> të kontrolluesit, ka për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.
2. Kontrolluesi nuk ka hartuar rregullore për funksionimin e sistemit të video-vëzhgimit CCTV. Hartimi i rregullores për funksionimin e sistemit të video vëzhgimit CCTV është një masë teknike dhe organizative për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrimet e paligjshme, aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, parashikuar në nenin 27 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Gjatë seancës dëgjimore, kontrolluesi ka shprehur gadishmërinë për marrjen e masave për rikuperimin e shkeljeve në vazhdimësi.

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 18, 27, 30, 31(1, a/1) dhe 32/1 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi "EUROGJICI-SECURITY shpk" Tiranë të hartojë dhe publikojë në portalin zyrtar të tij rubrikën "Politikat e Privatësisë";
2. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi "EUROGJICI-SECURITY shpk" të hartojë rregulloren për funksionimin e sistemit të video-vëzhgimit CCTV.

3. Kontrolluesi "EUROGJICI-SECURITY shpk" Tiranë, të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda afatit 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 13 10 2017

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

